

1. Çfarë është IÇK?

IÇK është indeksi mesatar vjetor i çmimeve të konsumit, i publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT) çdo vit. Sipas publikimit të INSTAT në muajin janar 2026, IÇK-ja për vitin 2025 është 2.2%.

2. Kur hyn në fuqi ndryshimi i tarifave?

Ndryshimi i tarifave hyn në fuqi më 1 maj 2026. One Albania, përpara përshtatjes së tarifës sipas IÇK-së, njofton pajtimtarët në përputhje me përcaktimet kontraktore.

3. Sa do të ndryshojë tarifa ime?

Referuar normës së IÇK-së për vitin 2025, tarifa juaj mujore do të ndryshojë jo më shumë se 2.2% mbi tarifën standarde. Tarifa e përshtatur i dërgohet pajtimtarit me link, nëpërmjet një SMS-je informuese dërguar nga One Albania.

Shembull: Nëse tarifa mujore standarde e planit tuaj tarifor është 1,000 Lekë dhe IÇK-ja e aplikuar është 2.2%, tarifa e re e përafërt do të jetë 1,020 Lekë. Nëse keni zbritje të përfituara në promocione, vlera e zbritjes nuk do të ndryshojë, por do të mbetet e njëjtë si para ashtu edhe pas aplikimit të IÇK-së. Për shembull, nëse vlera e zbritjes është 100 Lekë, ajo do të mbetet e pandryshuar, ndërsa vlera për t'u paguar pas zbritjes, nga 900 Lekë, do të bëhet 920 Lekë.

4. Përveç tarifës mujore të planit tarifor, a do të ketë ndryshime të tjera?

IÇK-ja do të aplikohet në tarifën mujore dhe në tarifën standarde për njësi: për thirrjet kombëtare e ndërkombëtare, për SMS-të kombëtare e ndërkombëtare, si edhe për internetin.

5. A aplikohet ky indeksim tarifash për të gjithë pajtimtarët?

IÇK-ja do të aplikohet vetëm për ata pajtimtarë të cilët janë pjesë e planeve mobile me kontratë, e Paketave Fiks në teknologjinë Bakër apo e HomeNet.

6. A ndryshon kohëzgjatja e kontratës sime?

Jo, afati i kontratës mbetet i pandryshuar. Ndryshimi lidhet vetëm me përditësimin e tarifës, siç është parashikuar në kushtet e përgjithshme të kontratës.

7. A mund ta ndërpres kontratën time për shkak të këtij ndryshimi?

Aplikimi i IÇK-së nuk ndikon në kushtet e tjera të kontratës, përfshirë këtu kohëzgjatjen e saj apo të drejtën për të përfunduar kontratën dhe detyrimet që rrjedhin nga ky përfundim.

8. A do të aplikohet IÇK-ja edhe për pajtimtarët me parapagim?

Jo, IÇK-ja nuk do të aplikohet për pajtimtarët me parapagim.

9. A ndryshon kësti i pajisjes sime (telefonit)?

Jo. Ndryshimi i IÇK-së aplikohet mbi tarifën standarde të shërbimit dhe jo mbi kështet e pajisjes suaj (telefonit).